

STATUT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"THE VALLEY GREEN SOLAR"

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", - i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" – i ndryshuar, sot më datë **22/12/2025**, themelohet shoqëria tregtare "The valleyGreen Solar" SH.P.K., veprimtaria e së cilës do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të mëposhtme të këtij Statuti.

Neni 1

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin shqiptar.

Neni 2

Ortakët e shoqërisë

Ortak i Vetëm i shoqërisë është **z. Fatos Sinaj**, shtetas shqiptar, lindur më **26.05.1978**, në Fier, mbajtës i letërnjoftimit me nr. **035688766** dhe nr. personal **H80526158B**.

Neni 3

Forma ligjore

Shoqëria ka formën e "shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar" ose "SH.P.K.". Megjithatë, ajo mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 5

Selia

5.1 Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Resorti "OlympusPalace", Rruga nacionale Fier-Berat, Zharrëz, Fier**.



- 5.2 Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen.

Neni 6

Dokumentet e shoqërisë

- 6.1. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondence, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë, përveç emrit të shoqërisë edhe të dhënat e mëposhtme:
- a) numrin unik të identifikimit;*
 - b) formën ligjore të shoqërisë;*
 - c) vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;*
 - c) të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;*
 - d) vlera e kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe vlera e pjesës së paguar të kapitalit;*
- 6.2. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

Neni 7

Objekti i veprimtarisë

- 7.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:
- Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike së prodhuar nga burime të rinovueshme nga burimet diellore, të erës apo hidrike.*
 - Studimi, projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i paneleve dhe centraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe infrastrukturës së impianteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike nga burime të rinovueshme nëpërmjet paneleve dhe parqeve fotovoltaike, hidrike dhe eolike.*
 - Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë elektrike.*
 - Ofrimi i asistencës teknike, riparimit dhe mirëmbajtjes së aparaturave, impianteve dhe linjave për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.*
 - Ndërtimi, mirëmbajtja dhe operimi i linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.*
 - Ndërtimi i linjave për prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemeve periferike për burimet e rinovueshme, ndërtimi dhe aktivitete të tregtimit në të gjitha format e materialeve të ndërtimit.*



- *Ndërmjetësim me komision për blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve të burimeve të energjisë së rinovueshme, parqeve diellore, turbinave me erë dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për të tjerët.*
- *Marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme.*
- *Shërbimet e komisionit financiar të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta.*
- *Importi dhe eksporti me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit të shoqërisë dhe të lejuara nga legjislacioni në fuqi për shoqërinë.*
- *Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar në Republikën e Shqipërisë i cili është në funksion ose jo të objektit të kësaj shoqërie.*

7.2 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

Neni 8

Kapitali themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është **10,000 (dhjetë mijë) Lekë**.
- 8.2 Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale **10,000 (dhjetë mijë) Lekë** e cila zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i pjesëve të kapitalit

- 9.1 Në eventualitetin e pasjes më shumë se një ortak, kuotat e kapitalit do të jenë lirisht të transferueshme mes tyre. Kapitali themeltar është lirisht i transferueshëm në rast trashëgimie, në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve apo paraardhësve e pasardhësve.
- 9.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek të tretët, qofshin këta subjekte shqiptarë apo të huaj, persona fizikë apo juridikë.

Neni 10

Zmadhimi/zvogëlimi i kapitalit

- 10.1 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve si dhe në përputhje me kërkesat ligjore.

- 10.2 Ortakët, me kërkesë të thjeshtë të administratorit, në mënyrë unanime dhe në përpjesëtim të drejtë të kuotave që posedojnë, mund të përmbushin nevojat financiare të shoqërisë nëpërmjet rritjes së kapitalit ose financimeve (qofshin këto me fitim/interes ose jo), duke respektuar normat e transparencës bankare dhe kërkesat të tjera me karakter fiskal. Rimbursimi i derdhjeve dhe i financimeve të ortakëve mund të bëhet me vendim të ortakëve, siç, me të njëjtat modalitete mund të destinohen për mbulimin e humbjeve eventuale ushtrimore.

Neni 11

Ortaku i vetëm/Asambleja e Ortakëve

- 11.1 Asambleja e Ortakëve përbëhet nga ortakët e shoqërisë. Ajo drejtohet nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person tjetër i zgjedhur nga ortakët.
- 11.2 Ortaku i vetëm apo eventualisht, Asambleja e ortakëve ka këto kompetenca kryesore:
- *ndryshimi i dispozitave të statutit,*
 - *zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit,*
 - *emërimi dhe ndryshimi i administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
 - *miratimi i shpërblimeve të administratorit, likuiduesve dhe ekspertit kontabël,*
 - *miratimi i llogarive vjetore(bilancit),*
 - *ndryshimi i formës ligjore të shoqërisë,*
 - *mbyllja dhe shpërndarja e parakohshme e shoqërisë si dhe të tjera të përcaktuara në legjislacionin shqiptar tregtar në fuqi.*
- 11.3 Asambleja e ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit dhe sa herë që duhet të vendosë për çështje të kompetencës së saj. Mbledhja mund të realizohet edhe nëpërmjet video-konferencës.
- 11.4 Mbledhja e Asamblesë thirret nga Administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit themeltar. Asambleja thirret me anë të një njoftimi me shkrim që u dërgohet ortakëve të paktën shtatë ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi mund të dërgohet edhe nëpërmjet postës elektronike por në çdo rast duhet të përmbajë ditën, orën, vendin si dhe rendin e ditës me çështjet që do të trajtohen.
- 11.5 Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë, bazuar në një prokurë të lëshuar paraprakisht, prej tyre.

Neni 12

Vendimmarrja

- 12.1 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.



-
- 12.2 Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të kualifikuar, asambleja e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë.
- 12.3 Asambleja e shoqërisë, vendos me 75% të kapitalit pjesëmarrës (të përfaqësuar nga ortakët), siç parashikohet në pikën 12.2 më sipër, për ndryshimin e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Në rastet e tjera, asambleja e shoqërisë, vendos me më shumë se 50% të votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje.
- 12.4 Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në një procesverbal, ku shënohet data, vendi, rendi i ditës, emri i drejtuesit të mbledhjes dhe mbajtësit të procesverbalit, çështjet kryesore dhe vendimet e marra. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari (mbajtësi i procesverbalit).

Neni 13

Administratori

- 13.1 Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Administratori zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- 13.2 Administratori i parë i shoqërisë është ortaku i vetëm i saj, **z. Fatos Sinaj**.
- 13.3 Administratori, ndër të tjera, ka të drejtë: të drejtojë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët, të paraqesë para Asamblesë së ortakëve propozime dhe raporte lidhur me aktivitetin e shoqërisë, të çelë llogari bankare në emër të shoqërisë, si dhe të drejta të tjera të cilat mund t'i njihen nga ligji dhe Asambleja e ortakëve.
- 13.4 Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
- 13.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

Neni 14

Kontrolli financiar

Asambleja e Ortakëve mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë.

Neni 15



Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Neni 16

Bilanci dhe Dividendët

- 16.1 Në fund të vitit ushtrimor, administratori, merr masa për përgatitjen e bilancit. Bilanci u paraqitet ortakëve për miratim, brenda afateve ligjore.
- 16.2 Asambleja e ortakëve që miraton bilancin vjetor, vendos mbi shpërndarjen e fitimit ortakëve ose krijimin e rezervave si dhe krijimin e rezervave ligjore.

Neni 17

Likuidimi dhe prishja

Likuidimi dhe prishja e Shoqërisë vendoset dhe kryhet në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 18

Dispozita mbyllëse

Ky Statut hartohet në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore.

ORTAKU I VETËM

FATOS SINAJ

Fatos Sinaj
